



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME VLORE SH.A

Nr._____, Prot.

Vlorë, më _____.____.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Marrje me qera automjete”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

34100000-8 – Automjete

VLERA E FONDIT LIMIT:

3,504,000 (tre milion e pesëqind e katër mijë) **Leke pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Vlore sha** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenet 76, 82 dhe 83 të LPP dhe Nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

- Sipas kritereve të përgjithshme

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së përlogaritur të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros se përcaktuar dhe te kerkuar nga autoriteti kontraktor kerkohet për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike te operatorit ekonomik si dhe per të vendosur kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedure eshte "E Hapur e Thjeshtuar mallra", përcaktimi i vlerës se kerkuar eshte bere ne mbështetje te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet se: Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës,, si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar,

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne mbështetje VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet se: " Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare".

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së fondit. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera,

afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim :

2.4.1 Operatori ekonomikë ofertues duhet të paraqesë autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar për automjete që do të marrin me qira objekt prokurimi. Autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, faks, email, faqe interneti, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktori, në rast verifikimi nga ana e tij

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Për të realizuar shërbimin e mësipërm Autoriteti Kontraktues ka nevojë të bashkëpunojë me operatorë ekonomikë të cilët i ofrojnë siguri. Autoriteti Kontraktues kërkon garanci nga ana e operatorit ekonomik gjë e cila vërtetohet me dokumentet e mësipërme.

Kërkesa për dokumentacionin e pronësisë së automjeteve lind pasi Autoriteti Kontraktues, do të marrë me qera dhe do të përdorë këto automjete çdo ditë për afatin kohor të caktuar ndaj duhet të bëjë të gjitha verifikimet e nevojshme lidhur me dokumentacionin e pronësisë së automjetit.

2.4.2 Operatori ekonomikë ofertues që do të realizojë këtë kontratë, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatën të vlefshme të ISO-ve (të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar) të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

ISO 9001: për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë, objekti i së cilës të ketë lidhje me objektin e prokurimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40 dhe 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Për të realizuar shërbimin e mësipërm Autoriteti Kontraktues ka nevojë të bashkëpunojë me operatorë ekonomikë të cilët i ofrojnë siguri Autoriteti Kontraktues kërkon garanci nga ana e operatorit ekonomik gjë e cila vërtetohet me dokumentet e mësipërme.

Kërkesa për ISO 9001:2015 lind pasi ky certifikim është një standard i njohur globalisht për menaxhimin e cilësisë. Ai ndihmon në përmirësimin e cilësisë, që operatorët ekonomikë të përmbushin pritshmëritë e klientëve

dhe të demonstrojnë përkushtimin e tyre ndaj cilësisë. Kërkesat e ISO-s 9001:2015 përcaktojnë se si të krijohet, zbatohet, mirëmbahet dhe përmirësohet vazhdimisht një sistem i menaxhimit të cilësisë. Zbatimi i ISO 9001 do të thotë që operatori ka vendosur procese efektive dhe staf të trajnuar për të ofruar produkte ose shërbime të përsosura herë pas here.

Standardi siguron që organizatat të kenë procese të fuqishme të kontrollit të cilësisë, duke çuar në rritjen e besimit dhe kënaqësisë së klientit.

2.4.3 Operatori ekonomikë ofertues duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit për automjete që të marrin me qira objekt prokurimi. Në katalog, të specifikohet në menynë e qartë dhe të dallueshme artikulli që oferton sipas modelit të deklaruar dhe të markohen edhe specifikimet përkatëse sipas DST. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të produktit që është objekt i prokurimit me qëllim që autoriteti kontraktor të vlerësojë nëse produkti i ofertuar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40 dhe 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kjo kërkesë lind pasi automjetit duhet të përmbushin kriteret e vendosura nga Autoriteti Kontraktues dhe kjo vërtetohet nëpërmjet kriterëve.

2.4.4 Operatori ekonomikë ofertues duhet të kenë paraqesë një deklaratë ku të specifikoj se:

- ✓ Pranon dhe merr persiper cdo shpenzim të automjetit dhe garanton se gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratave , do të jetojë i rregulluar për qark, persa i përket anës teknike të mjetit dhe dokumentimit të pandryshueshëm, sipas legjislacionit në fuqi.
- ✓ Garanton në cdo moment furnizimin me një automjet në gjendje pune, ekuivalent me ate te marre me qira të procedurave të prokurimit, në rastin kur ky i fundit ka një defekt ose është i paperdorshem për shkak të shërbimeve periodike të detyrueshme.
- ✓ Automjetet objektit prokurimi do të jetë në cdo moment të gatshem për t'u përdorur në rrugë, sipas nevojave të AK, të pajisura me dokumentacionin e rregullt, sipas dispozitave ligjore në fuqi, gjatë gjithë periudhës se zbatimit te kontrates.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40 dhe 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kjo kërkesë lidhet me faktin që është operatori ekonomik ai i cili në rast difektesh të automjeteve duhet të kryejë riparimet e nevojshme. Operatori ekonomik në rast defekti të njërit prej mjeteveve, garanton vënien menjëherë në dispozicion të një mjeti zëvendësues deri ne riparimin e tij, pasi automjeti qëndron në punë gjatë gjithë periudhës dhe një defekt i automjetit nuk duhet të ndaloj aktivitetin e autoritetit kontraktues për asnjë lloj arsye.

Në rastet e bashkimit të operatorëve, kriteret e veçanta të kualifikimit plotësohen bashkarisht nga i gjithë bashkimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike dhe termat e references jane hartuar nga specialist i fushës, i cili ka njohuri të posacme për objektin e prokurimit.

*Shënim: Specifikimet teknike dhe termat e references, për shërbimet objekt prokurimi, shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha shërbimeve dhe standardeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të shërbimit, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike dhe fondi limit i kontratës janë hartuar prej Autoritetit Kontraktor për nevojat e së cilës po kryhet kjo procedurë prokurimi.

Sipas specifikimeve bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DST.

Dokumentet e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarët e njësisë kanë akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP (www.app.gov.al).

Njesia e Prokurimit